



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2432/6 prot.

Datë 21.10.2025

V E N D I M
Nr. 1484/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.10.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e Thjeshtuar” – Marrëveshje Kuadër – Mallra”, me Nr. REF-58222-08-15-2025, me objekt “Furnizim vendosje të baterive dhe sistemin UPS”, me fond limit 3,740,000.00 (tre milion e shtatëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-08-2025, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

Ankimues: “SYNAPSE ATS” SHPK me NIPT L12321011H dhe adresë: Nj.Ad. 7, Rruga “Dritan Hoxha”, Pallati “MC-Inerte”, Kati 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Identitek SH.A me adresë: Rruga “Xhanfize Keko”, ish-Topografia Ushtarake, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18-08-2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e Thjeshtuar” – Marrëveshje Kuadër – Mallra”, me Nr. REF-58222-08-15-2025, me objekt “Furnizim vendosje të baterive dhe sistemin UPS”, me fond limit 3,740,000.00 (tre milion e shtatëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-08-2025, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

II.2. Referuar informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor Identitek Sh.a me shkresën me nr. 748/12 prot., datë 16.09.2025, rezulton se në datë 28-08-2025 është zhvilluar procedura e prokurimit, me pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. Sinteza Co SHPK	1,870,010.4 lekë pa tvsh
2. Alfa Services SHPK	2,200,000 lekë pa tvsh
3. Information Business Systems IBS SHPK	2,400,000 lekë pa tvsh
4. Synapse ATS SHPK	2,800,000 lekë pa tvsh
5. PC Store SHPK	2,805,000 lekë pa tvsh
6. Fredi Electronic SHPK	3,244,800 lekë pa tvsh

II.3. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton se me datë 08.09.2025 është publikuar në SPE njoftimi i anulimit të procedurës së prokurimit, publikuar në buletin e njoftimeve publike nr. Nr. 51, datë 15 shtator 2025.

II.4. Në datën 10.09.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5789 dhe me nr. 2432/2025 prot., datë 10.09.2025 e operatorit ekonomik “SYNAPSE ATS” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor, për anulimin e procedurës së prokurimit objekt – ankimi, konkretisht duke pretenduar se: “[...] Sipas njoftimit, arsyeja e anulimit është: “Konstaton se dokumentat e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme”. Duke analizuar këtë vendim, kemi vlerësuar se ai është i pabazuar në mënyrë të plotë në nenet e ligjit të prokurimit publik, për sa kohë që: 1. Dokumentacioni i tenderit ka qenë i disponueshëm për një kohë të mjaftueshme, duke i mundur Autoritetit Kontraktor që, përmes sqarimeve, të bëjë korrigjimet e nevojshme, përfshirë ndryshimin e kriterëve përkatëse, gjithmonë brenda afateve dhe në fazat e përcaktuara nga Ligji për Prokurimin Publik (LPP), madje deri në masën e anulimit të procedurës në një fazë më të hershme pa u dorëzuar ofertat, me qëllim që të bëhen korrigjimet përkatëse 2. Në rast se janë konstatuar gabime apo mangësi të rëndësishme në dokumentacionin e tenderit, ato është dashur të adresohen përmes korrigjimeve apo ndryshimeve të dokumenteve përkatëse dhe jo përmes anulimit të procedurës në fazën pas dorëzimit të ofertave, veçanërisht kur Autoriteti Kontraktor ka pasur mundësi paraprakisht të shqyrtojë vlerën përkatëse të secilit ofertues. Një veprim i tillë përbën shkelje të parimeve dhe rregullave themelore të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP). 3. Ligji nr. 162/2020, neni 98, parashikon se anulimi duhet të jetë një masë e fundit dhe i argumentuar në mënyrë të plotë, gjë që në këtë rast nuk rezulton të jetë bërë. 4. Ligji nr.162/2020, neni 75, citon se Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për cfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Si rrjedhojë, kjo është faza e përcaktuar ligjërisht, në të cilën Autoriteti Kontraktor duhet të ndërmarrë veprimet për korrigjimin apo ndryshimin e dokumentacionit të tenderit, në rast se konstatohen gabime apo mangësi të rëndësishme. Sa më sipër konsiderojmë se ky vendim çënon parimet e barazisë dhe transparencës, si dhe sjellë pasoja të drejtpërdrejta në konkurrencën e ndershme dhe në procesin e shpenzimit të fondeve publike.? Si dhe dëmton operatorët ekonomikë që kanë marrë pjesë në procedurë, duke rritur kostot dhe humbur kohë për përgatitjen e dokumentacionit, në një fazë ku aplikimi është kryer dhe investimi për pjesëmarrje është realizuar [...]”

II.5. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2432/1 prot., datë 11.09.2025.

II.6 Në datë 12.09.2025 është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2423/2 prot., “Formulari i Ankesës pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar nga operatori ekonomik “Synapse ATS” shpk, me të njëjtin objekt dhe përmbajtje ankese me ankesën me nr. 2432/2025 prot., datë 10.09.2025.

II.7. Me shkresën me nr. 748/12 prot., datë 16.09.2025 protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2432/3 prot., datë 22.09.2025 me lëndë “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt “Furnizim vendosje të baterive dhe sistem UPS”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Synapse ATS” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë si më poshtë vijon: “[...]Bazuar në nenin 75 pika 2 (në të kundërt) të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, së pari, arsyetimi ligjor i operatorit ekonomik ankimues do të kishte qenë i saktë nëse procedura e prokurimit, objekt i kësaj ankese do të ishte konstatuar a pasaktë përpara kalimit në fazën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO). Në këtë rast, duke qenë se KVO-ja që ka konstatuar pasaktësinë e specifikimeve të procedurës nuk ishte e mundur të anulohet procedura e prokurimit përpara dorëzimit të ofertave sepse KVO-ja i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentat e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, në përputhje me procedurat e specifikuara në dokumentat e tenderit (neni 90 pika 1 e ligjit për prokurimin publik). Në rastin konkret, pas shqyrtimit të email-eve të shkëmbyera ndërmjet KVO-së dhe Grupit të Punës që ka hartuar specifikimet teknike, konstatohet që pasaktësia në specifikimet teknike është konstatuar nga KVO-ja, të cilët më pas kanë iniciuar procedurën për ngritjen e problematikës. Së dyti, bazuar në nenin 98 pika 1 germa (c) në ligjin për prokurimin publik në fuqi, autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit kur konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme. Në asnjë rast, ky nen, nuk citon që anulimi duhet të jetë një masë e fundit. Përkundrazi, ligji për prokurimin publik në fuqi dhe aktet nënligjore nuk parashikojnë një procedurë “korrigjimi” për dokumentat standarde të Tenderit...”

Sa më sipër pretendimi i “Synapse ATS” SHPK nuk qëndron.

Referuar rastit konkret, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, vlerëson se (i) ankesa e “Synapse ATS” shpk nuk mund të bazohet ke neni 75 i ligjit për prokurimin publik në fuqi, dhe (ii) konstatohet se anulimi i procedurës është bërë konform ligjit në fuqi, si dhe rezulton se nuk ekziston asnjë propozim apo detyrim ligjor në lidhje me korrigjimin e dokumentave standarde të tenderit në rast mangësish të rëndësishme, në stadin e vlerësimit të ofertave, apo edhe në çdo stad tjetër të procedurës.

Në mbështetje të neneve 30,114 dhe 115 pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe procesverbalit për argumentimin e ankesës (bashkëlidhur), Komisioni i shqyrtimit të Ankesave

VENDOSI

1. Të refuzojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Synapse ATS” shpk procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e Thjeshtuar” – Marrëveshje Kuadër – Mallra”, me objekt “Furnizim vendosje të baterive dhe sistemin UPS”, me fond limit 3,740,000.00 (tre milion e shtatëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, me numër reference: REF-58222-08-15-2025.

[..]

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Synapse ATS” SHPK, mbi kundërshtimin e anulimit të procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 18-08-2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e Thjeshtuar” – Marrëveshje Kuadër – Mallra”, me Nr. REF-58222-08-15-2025, me objekt “Furnizim vendosje të baterive dhe sistemin UPS”, me fond limit 3,740,000.00 (tre milion e shtatëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-08-2025, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

III.1.2. Referuar informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor Identitek Sh.a me shkresën me nr. 748/12 prot., datë 16.09.2025, rezulton se në datë 28-08-2025 është zhvilluar procedura e prokurimit, me pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si më poshtë:

- | | |
|--|--------------------------|
| 1. Sinteza Co SHPK | 1,870,010.4 lekë pa tvsh |
| 2. Alfa Services SHPK | 2,200,000 lekë pa tvsh |
| 3. Information Business Systems IBS SHPK | 2,400,000 lekë pa tvsh |
| 4. Synapse ATS SHPK | 2,800,000 lekë pa tvsh |
| 5. PC Store SHPK | 2,805,000 lekë pa tvsh |

III.1.3. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton se me datë 08.09.2025 është publikuar në SPE njoftimi i anulimit të procedurës së prokurimit, publikuar në buletin e njoftimeve publike nr. Nr. 5, datë 15 shtator 2025.

III.1.4. Në datën 10.09.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5789 dhe me nr. 2432/2025 prot., datë 10.09.2025 e operatorit ekonomik “SYNAPSE ATS” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor, për anulimin e procedurës së prokurimit objekt – ankimi, konkretisht duke pretenduar se: “[...] Sipas njoftimit, arsyeja e anulimit është: “Konstaton se dokumentat e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme”. Duke analizuar këtë vendim, kemi vlerësuar se ai është i pabazuar në mënyrë të plotë në nenet e ligjit të prokurimit publik, për sa kohë që: 1. Dokumentacioni i tenderit ka qenë i disponueshëm për një kohë të mjaftueshme, duke i mundësuar Autoritetit Kontraktor që, përmes sqarimeve, të bëjë korrigjimet e nevojshme, përfshirë ndryshimin e kriterëve përkatëse, gjithmonë brenda afateve dhe në fazat e përcaktuara nga Ligji për Prokurimin Publik (LPP), madje deri në masën e anulimit të procedurës në një fazë më të hershme pa u dorzuar ofertat, me qëllim që të bëhen korrigjimet përkatëse 2. Në rast se janë konstatuar gabime apo mangësi të rëndësishme në dokumentacionin e tenderit, ato është dashur të adresohen përmes korrigjimeve apo ndryshimeve të dokumenteve përkatëse dhe jo përmes anulimit të procedurës në fazën pas dorëzimit të ofertave, veçanërisht kur Autoriteti Kontraktor ka pasur mundësi paraprakisht të shqyrtojë vlerën përkatëse të secilit ofertues. Një veprim i tillë përbën shkelje të parimeve dhe rregullave themelore të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP). 3. Ligji nr. 162/2020, neni 98, parashikon se anulimi duhet të jetë një masë e fundit dhe i argumentuar në mënyrë të plotë, gjë që në këtë rast nuk rezulton të jetë bërë. 4. Ligji nr.162/2020, neni 75, citon se Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për ccfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Si rrjedhojë, kjo është faza e përcaktuar ligjërisht në të cilën Autoriteti Kontraktor duhet të ndërmarrë veprimet për korrigjimin apo ndryshimin e dokumentacionit të tenderit, në rast se konstatohen gabime apo mangësi të rëndësishme. Sa mësipër konsiderojmë se ky vendim cënon parimet e barazisë dhe transparencës, si dhe sjellë pasoja të drejtpërdrejta në konkurrencën e ndershme dhe në procesin e shpenzimit të fondeve publike si dhe dëmton operatorët ekonomikë që kanë marrë pjesë në procedurë, duke rritur kostot dhe humbur kohë për përgatitjen e dokumentacionit, në një fazë ku aplikimi është kryer dhe investimi për pjesëmarrje është realizuar [...]”

III.1.5. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt,

numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2432/1 prot., datë 11.09.2025.

III.1.6 Në datë 12.09.2025 është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2423/2 prot., "Formulari i Ankesës pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik", dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar nga operatori ekonomik "Synapse ATS" shpk, me të njëjtin objekt dhe përmbajtje ankese me ankesën me nr. 2432/2025 prot., datë 10.09.2025.

III.1.7. Me shkresën me nr. 748/12 prot., datë 16.09.2025 protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2432/3 prot., datë 22.09.2025 me lëndë "Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar" me objekt "Furnizim vendosje të baterive dhe sistem UPS", autoriteti kontraktor ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues "Synapse ATS" SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë si më poshtë vijon: "[...]Bazuar në nenin 75 pika 2 (në të kundërt) të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, së pari, arsyetimi ligjor i operatorit ekonomik ankimues do të kishte qenë i saktë nëse procedura e prokurimit, objekt i kësaj ankese do të ishte konstatuar a pasaktë përpara kalimit në fazën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO). Në këtë rast, duke qenë KVO-ja që ka konstatuar pasaktësinë e specifikimeve të procedurës nuk ishte e mundur të anullohej procedura e prokurimit përpara dorëzimit të ofertave sepse KVO-ja i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, në përputhje me procedurat e specifikuara në dokumentet e tenderit (neni 90 pika 1 e ligjit për prokurimin publik). Në rastin konkret, pas shqyrtimit të email-eve të shkëmbyera ndërmjet KVO-së dhe Grupit të Punës që ka hartuar specifikimet teknike, konstatohet që pasaktësia në specifikimet teknike është konstatuar nga KVO-ja, të cilët më pas kanë iniciuar procedurën për ngritjen e problematikës. Së dyti, bazuar në nenin 98 pika 1 gërma (c0 në ligjin për prokurimin publik në fuqi, autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit kur konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme. Në asnjë rast, ky nen, nuk citon që anulimi duhet të jetë një masë e fundit. Përkundrazi, ligji për prokurimin publik në fuqi dhe aktet nënligjore nuk parashikojnë një procedurë "korrigjimi" për dokumentet standarde të Tenderit..."

III.1.8. Në nenin 98 "Anulimi i një procedure prokurimi" të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimi publik" i ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
- b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
- d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.

2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.

3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.

4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit dhe publikon njoftimin e anulimit.

5. Shfuqizuar

III.1.9 Në pikën 1 të nenin 38 “Njoftimi i Anulimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, autoriteti ose enti kontraktor harton njoftimin e anulimit, i cili dërgohet për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe u komunikohet të gjithë kandidatëve ose ofertuesve. Në rastin e procedurave të prokurimit, që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, ky njoftim publikohet në Buletin e Njoftimeve Publike. Me publikimin e këtij njoftimi, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit, sipas parashikimeve në LPP dhe në këto rregulla”

Në pikën 4 të nenit 75 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “4. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Përgjashtimisht, nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disa kriteret janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë t’i propozojë titullarit anulimin e procedurës. Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla”.

III.1.10. Lidhur me pretendimet e ankimuesit, për shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor në lidhje me anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, si të pabazuar në ligj, Komisioni vëren, se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit me arsyen si vijon: “në zbatim të germës c) të pikës 1, të nenit 98 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “.. c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme”, si dhe në zbatim të memos nr. 748/7 prot., datë 03.09.2025 me lëndë: “Mbi vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit “Furnizim vendosje të baterive dhe sistemit UPS” të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave”, publikuar në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 50, datë 15 shtator 2025, me datë të dorëzimit të njoftimit 03.09.2025, rezulton se anulimin autoriteti/enti kontraktues e ka bazuar në pikën (c) të nenit 98, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III.1.11. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Synapse ATS” SHPK për kundërshtimin e anulimit të procedurës së prokurimit, si dhe referuar informacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor Identitek Sha, me shkresën me nr. 748/12 prot., datë 16.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2432/3 prot., datë 22.09.2025, konkretisht referuar procesverbalit me nr. 748/6 prot., datë 03.09.2025 me lëndë “Sqarim i përmasave të baterive, për procedurën e prokurimit “Furnizim vendosje të baterive për sistemin UPS”, ku citoj si vijon: *“[...] në vijim të emailit të dërguar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, datë 02.09.2025, në kuadër të shqyrtimit të dokumentacionit teknik për saktësimin e përmasave të baterive aktuale, u shqyrtua përcaktimi i specifikimeve teknike të baterive VRLA 12V/80-90 ah. Në dokumentacionin e mëparshëm ishte pasqyruar formulimi: Përmasat aktuale të baterive (L x W x H): 302, 175, 227 (+2 mm)”. Pas verifikimeve dhe krahasimeve teknike, u konstatua se zëri tek specifikimet teknike “Përmasat aktuale të baterive (L x W x H) 302, 175, 227 (+2 mm)”, nuk përfaqëson përmasat aktuale të baterive që ne disponojmë dhe rezultoi se ky formulim është i pasaktë dhe ka ardhur si gabim në redaktim/referim. Për saktësi teknike, formulimi i rregulluar është: Përmasat maksimale të baterive (L x W x H): 302, 175, 227 mm. Ky korrigjim bëhet për të shmangur paqartësitë dhe për të reflektuar specifikimin e duhur të pajisjeve, në përputhje me standardet teknike dhe dokumentacionin e prodhuesit”, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit objekt ankimi, pasi KVO-ja ka konstatuar gabime në dokumentet e tenderit, konkretisht përsa i përket specifikimeve teknike, përmasave të baterive VRLA 12V/80-90 AH. Lidhur sa më sipër cituar, Komisioni konstaton, se në rastin konkret anulimi i procedurës së prokurimit ka ardhur, pasi KVO-ja ka konstatuar pasaktësi në formulimin dhe përmasave të baterive, konkretisht përcaktuar në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” si vijon: “Përmasat aktuale të baterive (L x W x H): 302, 175, 227 (+2 mm), ndërsa referuar përgjigjes së Grupit të punës pas kërkesës së KVO-së për saktësim të përmasave rezultoi se formulimi i saktë duhej të ishte “Përmasat maksimale të baterive (L x W x H) 302, 175, 227 mm.*

III.1.12 Sa më sipër arsyetuar Komisioni gjykon, se anulimi i një procedure prokurimi është një e drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktor, me kushtin që të respektojë përcaktimet e nenit 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe në rastin konkret ndodhemi në kushtet kur KVO-ja ka konstatuar gabime në hartimin e specifikimeve teknike, konkretisht referuar procesverbalit me nr. 748/6 prot., datë 03.09.2025, KVO-ja ka konstatuar gabime përsa i përket përmasave të baterive dhe në këto kushte autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit me njoftimin e anulimit të datës 03.09.2025, publikuar në SPE në datë 08.09.2025 dhe në buletin e prokurime publike nr. 50, datë 15.09.2025, duke e mbështetur anulimin e procedurës së prokurimit në germën (c) të nenit 98 të LPP-së, ku parashikohet shprehimisht se: *“Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme”*. Referuar arsyes së anulimit Komisioni gjykon, se gabimi i konstatuar nga ana e KVO-së mbi përmasat e baterive nuk mund të konsiderohet gabime apo mangësi të rëndësishme në dokumentet e tenderit. Akoma më tej Komisioni gjykon, se përmasat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” si vijon: “Përmasat aktuale të baterive (L x W x H): 302, 175, 227 (+2 mm), janë më gjithëpërfshirëse në raport

me saktësimin e kryer nga njësia e prokurimit, si dhe nuk ndikojnë në funksionalitetin e pajisjeve objekt prokurimi. Në kushtet kur këto përmasa nuk çënojnë funksionalitetin e pajisjes objekt prokurimi, si dhe nuk ndikojnë në ngushtimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomik Komisioni gjykon, se gabimi i konstatuar nuk përbën gabim thelbësorë në dokumentet e tenderit dhe nuk përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit.

Akoma më tej referuar pikës 4 të nenit 75 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: “4. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Përfundimisht, nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disa kriteret janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë t’i propozojë titullarit anulimin e procedurës. Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla”, Komisioni gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar edhe rastin kur përjashtimisht KVO-ja mund t’i propozojë titullarit të autoritetit kontraktor anulimin e procedurës së prokurimit, por referuar bazës ligjore të sipërcituar Komisioni gjykon, se nuk ndodhemi në të njëjtat kushte, akoma më tej kur gabimet e konstatuara në specifikimet teknike, nuk konsiderohen gabime apo mangësi thelbësore, pasi nuk çënojnë funksionalitetin e pajisjes objekt prokurimi. Duke analizuar situatën më sipër, ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, KPP gjykon, se anulimi i procedurës së prokurimit nuk është bërë në përputhje me nenin 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Synapse ATS” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e Thjeshtuar” – Marrëveshje Kuadër – Mallra”, me Nr.

REF-58222-08-15-2025, me objekt “Furnizim vendosje të baterive dhe sistemin UPS”, me fond limit 3,740,000.00 (tre milion e shtatëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-08-2025, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të mësipërme dhe ta rikthejë atë në momentin procedural të vlerësimit të ofertave.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Synapse ATS” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

